



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 197, datë 9.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E ORGANIKËS SË AUTORITETIT KOMBËTAR
TË INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E OPERIMIT NË AVIACIONIN
CIVIL**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Organika e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Numri i punonjësve të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil të jetë, gjithsej, 8 veta.
3. Urdhri nr.6, datë 21.1.2011, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**ORGANIKA E AUTORITETIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT PËR SIGURINË
E OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL**

SKEMA 1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1 DREJTOR	II-b	1
INSPEKTOR	III-a	5
SPECIALIST	IV-a	2
PUNONJËS GJITHSEJ		8

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 6537/1
DATË 12.12.2022

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
AUTORITETIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT PËR
SIGURINË E OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI



Engjëll Agaci

